



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr.06
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303
Prishtinë, më 22 qershor 2021, në orën 10:00

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë : Fatmire Kollçaku, Labinotë Demi- Murtezi, Haxhi Avdyli, Mirsad Shkreta, Burim Karameta, Bekim Haxhiu, Shemsedin Dreshaj, dhe Samra Ilijazi, anëtarë.

Munguan : Armend Zemaj, Miljana Nikoliq, dhe Uran Ismaili, anëtarë.

Stafi mbështetës: Shpresa Haxhijaj, koordinatorë dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë i fushës/analist.

Pjesëmarrës të tjerë: Granit Bllaca, KDI; Violeta Salihu, KSH; dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Fatmire Kollçaku, kryetare e komisionit.

RENDI I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 31.5.2021 dhe 1.6.2021;**
- 3. Miratimi i fushëveprimit të Komisionit;**
- 4. Rishqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2021;**
- 5. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 31.5.2021 dhe 1.6.2021;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më datën: 31.5.2020 dhe 1.6.2021, u miratua pa vërejtje.

3.Miratimi i fushëveprimit të Komisionit;

Fatmire Kollçaku, tha se siç jeni të njoftuar pas kërkesës së Komisionit për Shëndetësi, drejtuar Kryesisë së Kuvendit, që Komisionit për Shëndetësi, t'i shtohet dhe sektori i Mirëqenies Sociale, duke e përfshirë edhe fushëveprimin e kësaj fushe, sepse nuk ishte e përfshirë në emërtimin e asnjë komisioni parlamentar dhe ka mbetur e pambuluar. Kjo kërkesë është miratuar në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 08-V-006, datë 2.4.2021, për formimin e 14 komisioneve parlamentare, ndryshohet emërtimi i komisionit, Pika II. 9, ndryshohet si në vijim: Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Tani është rikthyer fushëveprimi që është kërkuara nga komisioni dhe që ka qenë dhe nga legjislatura e kaluar, sektori i mirëqenies sociale.

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, është Komision funksional, i cili në kuadër të fushëveprimit dhe përgjegjësisë, i shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me shëndetësinë dhe mirëqenien sociale.

Fushëveprimi i Komisionit:

- Angazhimin për përcaktimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave për zhvillimin dhe funksionimin efikas të shëndetësisë dhe të mirëqenies sociale;
- Angazhimin për konceptimin e strategjisë së përgjithshme për mbrojtjen shëndetësore të qytetarëve të Kosovës dhe të qytetarëve të tjerë, që përkohësisht gjenden në Kosovë, duke nxitur aplikimin e standardeve bashkëkohore të shëndetësisë;
- Angazhimin për sigurimin e një mirëqenieje të kënaqshme në Kosovë, duke i përfshirë sigurimin dhe mbrojtjen sociale të qytetarëve të Kosovës, mbrojtjen sociale të invalidëve të luftës, të familjeve të dëshmorëve, të invalidëve të punës, të të burgosurve politikë dhe të familjeve të tyre, të të gjitha kategorive të të paaftëve për punë dhe ndërtimin e një sistemi të efektshëm pensional për të gjitha kategoritë.
- Angazhimin për shqyrtimin e programit të Qeverisë, të mënyrës dhe të nivelit të zbatimit të tij në fushën e shëndetësisë dhe të mirëqenies sociale dhe i jep rekomandime Kuvendit;

- Angazhimin për identifikimin e programeve specifike të Qeverisë, përkatësisht të ministrisë së resorit përkatës dhe në bashkëpunim me Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, e bën shqyrtimin e hollësishëm si është bërë financimi dhe menaxhimi i tyre;
- Shqyrtimin e legjislacionit të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrisë së resorit përkatës dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke i përfshirë edhe amendamentet;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të fushëveprimit të tij;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera, të përcaktuara me këtë Rregullore dhe të çështjeve, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

Për ushtrimin e funksioneve, Komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministritë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke i përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohej nga Komisioni.

Haxhi Avdyli, tha se është lajm i mirë që pjesa e mirëqenies sociale është adresuar në Komision për Shëndetësi dhe është një angazhim shtesë, po ashtu edhe në planin e punës duhet të futet edhe fusha e mirëqenies sociale. Propozoj që të kemi një takim informues rreth planit të Qeverisë, ku do të ftohen departamentet përkatëse të mirëqenies sociale, shoqata e pensionistëve, familjeve të dëshmorëve, dhe të marrim input nga ta, sepse është e nevojshme që Kosova të hyjë në sferën pensionale të reformave, pasi që ka paqartësi, dhe ankesa në disa ligje që i rregullojnë këto çështje. Prandaj, duhet të behën ndryshimet e duhura në legjislacionin e skemave pensionale, në mënyrë që të rregullohen këto probleme, që po na paraqiten tash një kohë të gjatë, siç është Ligji për Statusin dhe të Drejta e Dëshmoreve, sepse prindërit e tyre, pensionistë, në bazë të këtij ligj nuk mund ta gëzojnë të drejtën e marrjes së pensionit si familjar të dëshmorit, kur e marrin pensioni e tyre të pleqërisë që ju takon dhe ky diskriminim duhet të mënjanohet.

E kemi Ligjin për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti, duhet të rregullohet çështja stazhit për 15 vjet përvojë punë para viti 1999 (para luftës) sepse këtë të drejtë nuk po mund ta gëzojnë të gjithë që po pensionohen dhe nuk po mund ta marrin pensionin e plotë, por vetëm atë të pleqërisë dhe kjo çështje duhet të rregullohet duke hequr këtë masë kufizuese.

Është po ashtu edhe Ligji për Veteranët e Luftës, që e gëzojnë vetëm ata që nuk kanë punë tjetër dhe kjo duhet të ndryshohet, të ju lejohet kjo drejtë, në mënyrë që t'ju lejohet mundësia dhe të punojnë qoftë me gjysmë orari dhe ta gëzojnë këtë të drejtë që iu takon.

Mirsad Shkreta, tha se pajtohet më koleget parafolës për fushëveprimin dhe emërtimin që i është rikthyer komisionit, është vendim i duhur që kanë bërë të gjitha Grupet Parlamentare, më votim në seancën plenare. Neve si komision na mbetet t'i trajtojmë shumë tema nga këndvështrimi i mirëqenies sociale. Ndërsa, sa i përket rishqyrtimit të planit të punës, ai duhet të harmonizohet, në bazë të dinamikës së punës, pasi që Qeveria ka planifikuar që projektligjet që i përkasin sektorit të mirëqenies sociale, t'i sjellë në fund të vitit dhe në bazë të kësaj do të veprojmë si komision.

Labinotë Demi- Murtezi, tha që është për t'u përshëndetur vendimi i Kuvendit në seancën plenare, për rikthimin e fushëveprimit dhe emërtimin e Komisionit, siç ka qenë nga legjislatura e kaluar. Andaj ne tani duhet që t'i kemi në konsideratë shumë punë shtesë të mirëqenies sociale, shume tema që janë ngritur dhe propozime të projektligjeve nga mandati i kaluar, por që kanë mbetur pa përfunduar, që kanë të bëjnë më barazinë sociale dhe rregullimi i këtyre temave dhe miratimi i projektligjeve, është i domosdoshëm për mirëqenien sociale të qytetarëve.

Shemsedin Dreshaj, tha se shtimi i kompetencës së fushëveprimit të mirëqenies sociale do të jetë një angazhim shtesë për komisionin, por edhe ne si deputetë duhet të jemi të përkushtuar për mirëqenien sociale të qytetarëve. Ai theksoi se pajtohet me kolegun Haxhi Avdyl, lidhur më rregullimin e stazhit të punës, për të punësuarit që po pensionohen në moshën 65 vjeçare, dhe nuk po mund ta arrijnë koten prej 15 vjetëve para vitit 1999, për ta gëzuar të drejtën plotë të marrjes së pensionit. Prandaj, është më se i domosdoshëm plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për skemat pensionale të financuar nga Shteti, dhe shumica e këtyre ligjeve që rregullojnë sektorin e mirëqenies sociale, dhe që janë ndesh me njëri-tjetrin, duhet të harmonizohen. Për këtë çështje duhet të kërkohet nga Qeveria, ta rrisin koston buxhetore për mirëqenie sociale.

Dreshaj propozoi që lidhur më këto tema që u ngritën të ketë takime me përfaqësuesit e Sindikatës së Pensionistëve, dhe kohen kur ta rishikojmë Ligjin për buxhetin e Shtetit, si komision ta japim kontributin tonë.

Fatmire Kollçaku, sqaroi se fushëveprimi i Komisionit tani e tutje është edhe shqyrtimi i të gjitha projektligjeve, që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, po ashtu, do jetë edhe angazhimi për sigurimin e një mirëqenie më të mirë për të gjitha kategoritë sociale e në veçanti për personat më aftësi të kufizuar, që do t'i trajtojmë kërkesat që vijnë nga ata, për sigurimin social të tyre.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim:

4. Rishqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2021;

Fatmire Kollçaku, tha se sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, ky plan është dinamik dhe mund të rishikohet, duke u bazuar, sipas Programit legjislativ të Qeverisë për vitin 2021. Ajo tha që do ta plotësojmë në sesionin vjeshtor, pasi që pjesa këtyre projektligjeve që i përkasin pjesës së sektorit të mirëqenies sociale, pritet të silltet nga Qeveria në Kuvend, nga fundi i kësaj pjese të sesionit vjeshtor dhe pastaj do të bëjmë plotësimin e këtij plani dhe nga sesioni vjeshtor të jemi të angazhuar edhe në fushën e projektligjeve të mirëqenies sociale.

Kollçaku i potencoi projektligjet që priten të vijnë në sesionin vjeshtor si në vijim: Projektligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare; Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti; Projektligji për Skemën e Ndhimave Sociale; Projektligji për Pensionimin e Zyrtarëve Policorë.

Kollçaku theksoi se do të angazhohen si komisionin ta bëjnë më të mirën edhe sa i përket buxhetit për këto kategori të mirëqenies sociale.

Komisioni njëzëri vendosi, që Rishqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2021, të bëhet në sesionin vjeshtor.

5. Të ndryshme

Fatmire Kollçaku, kyetare, i njoftoi anëtarët e komisionit, lidhur me aktivitetet që i ka pasur në cilësinë e kryetares së komisionit, Me Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm, kemi zhvilluar punëtori që lidhet me agjendën 2020-2030 dhe që duhet të përmbushën objektivat nga ana e Kuvendit të Kosovës, në bazë të Rezolutës për zhvillim të qëndrueshëm, dhe si komision duhet ta kemi një strategji 10 vjeçare për t'i realizuar këto objektiva, që i përkasin fushës së komisionit.

U tha se OJQ Koalicion (K-10), na ka ftuar në një takim, ku kërkesat e tyre janë për shëndetin riprodhues të nënave.

Bekim Haxhiu, ngriti çështjen e procesit të vaksinimit kundër pandemisë COVID, dhe tha se ky proces është duke shkuar ngadalë, ndonëse është premtuar nga Qeveria një vaksinim masiv. Dhe për këtë çështje ka propozuar që komisioni të bëjë kërkesë në Ministrinë e Shëndetësisë, që të ketë qasje në kontratën për blerje të vaksinave që është nënshkruar me kompaninë “Pfizer” dhe aty ta shikojmë të vërteten se kur

mund të furnizohemi më vaksina, të informohemi se kur do të vijë doza e parë vaksinave, e dyta, për çdo muaj, me sa vaksina do të furnizohemi dhe a do të ketë në dispozicion vaksina çdoherë për dozën e dytë.

Haxhiu tha se mbetet brengosëse, heshtja e Qeverisë që ekipet e vaksinimit në komunat veriore të Kosovës, janë larguar dhe nuk ju është lejuar që ta kryejnë punën e tyre për vaksinimin e qytetareve në atë pjesë të shtetit tonë.

Fatmire Kollçaku, tha se tashmë ka filluar vaksinimi masiv i qytetarëve, ekipe do të ketë mjaftueshme. Lidhur më këtë çështje mund të kërkojmë një raport rreth ecurisë së vaksinimit dhe ajo çfarë kemi parë deri më tani, është që ecuria po vazhdon në rregull dhe ka vaksina. Ajo potencoi se zotimi i Qeverisë ka qenë që do të vaksinohet një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve dhe një kontingjent shumë shpejt do të arrijë.

Shemsedin Dreshaj, tha se është e rëndësishme dinamika e ardhjes së vaksinave, por njëkohësisht është për t'u shqetësuar që kemi kaq pak vaksina për këtë periudhë në stoke për t'i përdorur, kur shumica vendeve kanë rezerva dhe për dozën e dytë në ende po ballafaqohemi më problemin e furnizimit. Prandaj, i kisha rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë, që ta ndryshojë metodologjinë e planit të vaksinimit, pasi që i kemi të angazhuar 270 ekipe për këtë plan, dhe kur dihet se për këto ditë nuk kemi rezerva të mjaftueshme të dozave, atëherë dinamika ecurisë së numrit të të vaksinuarve mund të ulet, për të mos e rrezikuar vaksinimin për dozën e dytë. Ai theksoi se pajtohet më koleget, që kërkohet nga MSH-ja, të dijë më shumë detaje sa i përket ardhjes së vaksinave në vend.

Mirsad Shkreta, tha që të dy kërkesat nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, nëse ne kërkojmë raport nga Ministra e Shëndetësisë, aty mund të na paraqesin dhe përfshijnë edhe detajet e gjithë procesit të vaksinimit, si po shkon dhe kur mund të arrijnë dozat e reja të vaksinave kundër COVID.-19.

Haxhi Avdyli, tha se kërkesa për të kërkuar raporti lidhur më ecurinë e vaksinave është legjitime, duhet të kërkohet raport sipas vendeve dhe moshës që po vaksinohen. Lajmet e fundi janë të mira, që shumë shpejt do të arrijë donacioni nga SHBA-ja i vaksinave "Pfizer", gjithashtu, e mira e kësaj pandemie është së tani e kemi trendin e numrit të uljes në masë të madhe të lakores me raste të vdekjeve dhe më raste pozitive.

Bekim Haxhiu, theksoi se është bërë shumë pak punë për të përmbushur nevojat e qytetarëve për vaksinim dhe bazuar në të dhënat Qëndresë së Vaksinimit, rezulton se Kosova ka 178 mijë doza të vaksinave donacion, ende nuk ka marrë asnjë kontingjent të blerë nga "Pfizer". Prandaj për këtë po insistoj që ta kemi qasje si Komision mbikëqyrës që monitorojmë punën e MSH-së, lidhur me nënshkrimin e kontraktimit

me kompaninë prodhuese “Pfizer”, për furnizim të vaksinave kundër pandemisë COVID -19, sepse këtë gjë na lejon edhe Ligj për qasje në dokumente Publike. Haxhiu kërkoi që të hedhet në votim propozimi i tij, të ketë qasje në kontratën e nënshkruar ne mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe kompanisë “Pfizer”.

Fatmire Kollçaku, tha se duhet të kërkohet raport për ecurinë e vaksinimit dhe planifikimit nga MSH-ja që i ka për realizimin e planit të vaksinimit, dhe mund të informohemi në detaje mbi ecurinë e vaksinimit.

Pas debatit, votimi i propozuar për të kërkuar raport nga MSh-ja për ecurinë e vaksinimit, u miratua, kurse u refuzua kërkesa që të kërkohet qasje për ta shikuar komisioni, kontratën e nënshkruar në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Kompanisë “Pfizer”, prodhuese e vaksinave kundër COVID -19.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Fatmire Kollçaku,

Kryetare e Komisionit